



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

-IV- Nr. i prot. 629 Më 14.01.2021
Br. prot. Dt. RAHOVEC - ORAHOVAC



PLANI VJETOR I PUNËS I DREJTORISË KOMUNALE PËR ARSIM PËR VITIN 2021

Përmes këtij plani, Drejtoria për Arsim për vitin 2021 do të realizojë aktiviteteteve të shumta me qëllime, synime dhe prioritete të qarta.

Qëllimet kryesore të DKA-së janë:

- përmirësimi i kushteve për mësimdhënie frytdhënëse,
- mbarëvajtja e procesit edukativo arsimor, dhe
- arritja e sukseseve më të mëdha të nxënësve të të gjitha niveleve.

Synimet kryesore e DKA-së për vitin 2021 janë:

- Funkcionalizimi i plotë Ekipeve për Parandalimin dhe Reagimin kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të nxënësve (EPRBM) nëpër shkolla ;
- Funkcionalizimi i plotë i aktivave profesionale (AP) në secilën shkollë;
- Riparimet dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore;
- Përfundimi i investimeve të planifikuara në ndërtimin e çerdheve për fëmijë;
- Përfundimi i projekteve për ndërtimin e shkollave të reja të filluara nga viti 2018 dhe 2019;
- Furnizimi i shkollave me libra, pajisja me mjete konkretizimi e laboratorike, me pako pedagogjike dhe teknologji informative;

Prioritetet themelore të DKA-së për vitin 2021 janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve shkollore
- Mbarëvajtja e procesit edukativo arsimor
- Nxitja e nxënësve për të mësuar përmes organizimit periodik të garave të diturisë në secilin nivel arsimor.
- Ngritja e cilësisë në arsim

- **Në tremujorin e parë**, përveç që do të analizohet vijueshmëria dhe suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë, do të bëhen përgatitjet e nevojshme për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë. Do të mbajmë aktive aktivet profesionale në secilën shkollë, të cilat do të jenë në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me Ekipin Profesional Monitorues dhe Vlerësues (EPMV) të DKA-së. Nga Fondi I Kosovës për Eficiencë të Energjisë, presim të fillojë implementimi i projekteve të fituara nga Komuna jonë për zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në 5 shkolla dhe do të zhvillojmë aktivitete kulturore dhe garuese me nxënës për nder të festive të 17 shkurtit dhe 7 Marsit. Në muajin janar do të nisim procedurën e prokurimit për kontratën e furnizimit të çerdhes për fëmijë me ushqim e pije, ndërsa në muajin mars do të nisim procedurën për realizimin e kontratës për furnizimin e bibliotekave të shkollave me libra.
- **Në tremujorin e dytë**, Ekipi Profesional Vlerësues dhe Monitorues i DKA-së do të angazhohet në të gjitha shkollat dhe do të koordinojë veprimet me aktivet profesionale të shkollave, për t'u siguruar që ecuria e procesit të realizimit të planprogrameve mësimore dhe pakos pedagogjike po ecën mirë. Do të mbajmë gara të diturisë me nxënësit e të gjitha niveleve dhe të shumicës së lëndëve mësimore. Poashtu, do të bëhen përgatitje dhe do të organizohet testi i maturës për nxënësit e klasave të 12-ta dhe testi i arritshmërisë për nxënësit e klasave të 9-ta. Do të zhvillojmë takimet e rregullta me drejtorët e shkollave, me ç'rast do të bëhet një analizë e përgjithshme e procesit mësimor gjatë vitit mësimor. Në këtë periudhë do të nisen procedurat e prokurimit për lidhjen e kontratave për projektin e ndërtimit të rrethojës së shkollës "Rilindja" në Çifllak, për projektin e instalimit të ngrohjes qendrore në SHML "Xhelal Hajda-Toni" dhe për projektin e pajisjes së shkollave me mjete konkretizimi dhe laboratorike. Poashtu, në këtë periudhë, DKA do të pranojë dhe analizojë raportet e punës së dy ekipeve, EPRMB-së dhe EPMV-së dhe do të përcjellë hap pas hapi ecurinë e ndërtimit të shkollave dhe çerdheve.

Në gjashtëmujorin e parë synimi ynë kryesor do të jetë përmbyllja e vitit mësimor me një zvogëlim të ndjeshëm të mungesave të nxënësve, sidomos në Shkollat e Mesme të Larta dhe ngritja e nivelit të cilësisë në Arsim, në të gjitha nivelet. Poashtu, në kuadër të DKA-së në këtë periudhë do të nisin procedurat për shumicën e projekteve të parashikuara.

- **Në tremujorin e tretë**, do të bëhet planifikimi i kuadrit mësimor për vitin shkollor 2021/2022 si dhe do të fokusohemi edhe në riparimin e objekteve shkollore përmes zbatimit të kontratës për Riparime në Shkolla Lot1 dhe Lot2. Do të analizohen sukseset dhe mangësitë e vitit shkollor 2020/2021 dhe do të bëhen përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022. Do të nisim procedurat e prokurimit për projektin "Mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore në shkollat e komunës së Rahovecit". Të gjitha SHFMU-të do të furnizohen me tekste mësimore dhe do të marrim të gjitha masat e nevojshme që viti i ri shkollor të fillojë mbarë në të gjitha shkollat. Në këtë periudhë, do të bëhet gati edhe planifikimi i projekteve kapitale për arsim për vitin pasues 2022, dhe përmes kontratave të lidhura do të bëhet furnizimi i bibliotekave të shkollave me libra, mjete konkretizimi, pajisje laboratorike dhe të teknologjisë informative. Do të bëhet furnizimi me lëndë djegëse për ngrohje për të gjitha shkollat dhe institucionet edukativo arsimore para muajit Nëntor dhe do të përcillet vazhdimisht realizimi i projekteve kapitale në fushën e arsimit.
- **Në tremujorin e katërt**, do të mbahen takime me drejtorët e shkollave dhe me koordinatoret e cilësisë për mbarëvajtjen e procesit edukativo arsimor për periudhën e parë vlerësuese të vitit të

ri shkollor dhe për ecurinë e zbatimit të planprogrameve mësimore. Gjithashtu, EPMV do të vizitojë të gjitha shkollat, me ç`rast do të koordinojë veprimet me aktivet profesionale të shkollave. Drejtori i DKA-së do të realizojë takime të njëpasnjëshme me këshillat e arsimtarëve të çdo shkollë.

Në gjatëmujorin e dytë, synojmë t`i arrijmë qëllimet tona për t`i realizuar dhe përfunduar të gjitha projektet kapitale dhe projektet që kanë të bëjnë me mallra e shërbime për furnizimin e shkollave. Të gjitha këto në funksion të ngritjes së cilësisë në Arsim.

